




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“Klan Kosova” Sh.p.k.  
Numri i biznesit - 70542943  
Drejtor –Baton HAXHIU  
OSHMA KLAN KOSOVA  
Zona Industriale  
(ish-Fabrika e Amortizatorëve)  
Prishtinë

Ref:1902/187//LIC/ni

## VENDIM

*për ripërtitjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes Klan Kosova, me seli në Prishtinë*

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Klan Kosova është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e programeve televizive përmes sistemit të operatorëve të shpërndarjes. KPM, me datën 18 shkurt 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës për OSHMA Klan Kosova.
3. Me datën 18 shkurt 2019, skadon afati i licencës së Klan Kosova, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtitjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 28 dhjetor 2018, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar, përmes e-mali, Ofruesin e Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes Klan Kosova, lidhur me skadimin e licencës në vitin 2019, si dhe me afatet dhe obligimet që parashihen me nenin 25 të Ligjit për KPM, për ripërtitje të Licencës së KPM-së.

5. Më 28 dhjetor 2018, Klan Kosova ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtëritje të Licencës së KPM-së.

### Arsyetimi

6. OSHMA Klan Kosova, ka shfrytëzuar mundësin që i ofron Neni 25 i Ligjit të KPM-së dhe ka parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së, në pajtim me procedurat e përcaktuara nga KPM.
7. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

*“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,*

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

### VENDIM

8. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 22 shkurt 2019, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së KLAN KOSOVA, për të ushtruar veprimtarin si ofrues i shërbimeve mediale audiovizuale, me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
9. Licenca e KPM-së për OSHMA Klan Kosova do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 18 shkurt 2019.
10. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, të OSHMA Klan Kosova, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



22.02.2019

datë